



01/Nr. 43/2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11 , 40, 12.2 shkronja (d), Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal numër Nr.03/L-049 neni 2 , Rregullore për Kushtet , Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve 01/Nr.11159/2016, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2017 merr:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR BURSA PËR STUDENTËT DHE CAKTIMIN E PRIORITEVE PËR KUADRA DEFICITARE PËR KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për bursa për studentët për vitin akademik 2016/2017 dhe caktimin e prioriteteve për kuadra deficitare për Komunën e Hanit të Elezit.

II

Duke ju referuar nenit -I- të këtij vendimi mjetet të cilat do të dedikohen për ndarjen e bursave për studentë merren nga kodi ekonomik subvencione dhe transfere vlere e të cilave është prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro), që do të përfitojnë 20 (njëzet) studentë për dhjetë muaj nga 50.00 € (pesëdhjetë euro) në muaj. Prioritete për kuadra deficitare janë në lëmin:
Fakulteti i Mjekësisë (Mjekësi e Përgjithshme, Fizioterapi). Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (Ndërtimtari dhe i Arkitekturë). Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (Inxhinieri Kompjuterike, Telekomunikacion, Elektronikë, Automatikë, Sistemet Elektroenergjetike, Elektroenergjetikë Industriale). Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (Prodhimtari dhe Automatizim, Termoenergjetikë dhe termoteknikë, Konstrukione dhe mekanizim, Komunikacion). Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (Agroekonomi, Bioteknologji në Zootekni, Lavërtari – Perimtari, Mbrojtje e Bimëve, Pemëtarë – Vreshtari, Veterinari). Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë (Xehetarisë, Gjeologjisë, Materiale dhe Metalurgji, Teknologjisë), në rast të mos plotësimit të bursave sipas kuadrit deficitare, plotësohet sipas rregullores për Kushtet , Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Arsim Kulturë Rini dhe Sport, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 26. 01. 2016

Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 46/2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 37, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 55, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2017 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2017

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës së Komitetit për Komunitet për vitin 2017.

II

Duke ju referuar nenit I të këtij vendimi pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës së Komitetit për Komunitet për vitin 2017.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendimi njoftohen: Kryetari i Komunës, Anëtarët e Komiteti për Komunitete, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 26. 01. 2017

Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr.45/2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 11, 12 shkronja (d), 40, Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012-MPB-032012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi neni 9 pika 1.7, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2017 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2017

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2017.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2017 për komunën e Hanit të Elezit.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 26.01.2017





01/ Nr.54/2017

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 nenit 11, 40, Udhëzimin Administrativ Nr.01/2016 për Procedurat e Themelimit , Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, neni 11 pika 3, Statutin e Komunës neni 37, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit neni 55, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2017 merr:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR TRI KOMITETET KONSULTATIVE PËR
VITIN 2017

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës për tri komitetet konsultative të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2017.

II

Duke ju referuar nenit I të këtij vendimi, pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës për vitin 2017 për mbledhjet që do të mbahen për komitetin konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit, për komitetin konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për komitetin konsultativ për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Komiteti për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit, Komiteti për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komitetin për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 26.01.2017

Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.449/2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 neni 11, Ligji mbi Ujërat e Kosovës Nr. 2004/24 neni 56, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-25 neni 8, Ligji për Procedurën Administrative 02/L-28 neni 107, 126, dhe në bazë të kërkesës së palës me numër 06/Nr.430, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më 26.01.2017 merr:

V E N D I M

PËR PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KOMPANINË „AFA ENERGY”
SH.P.K PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT

I

I jepet në parim pëlqimi kompanisë „Afa Energy” sh.p.k për ndërtimin e hidrocentralit HC KOTLINË me kapacitet prej 4.9 MW dhe shfrytëzimin e parcelave me numër Nr. 1387-0 me kulturë Lum në vendin e quajtur Koka Reka e evidentuar në certifikatën e pronësisë P.SH. UJRAT zona kadastrale Pustenik me sipërfaqe prej 03 99 09 ha, parcela kadastrale me numër Nr. 183-0 me kulturë kullosë e klasit pestë në vendin e quajtur Kraviq P.SH EKONOMIA E PYJEVE zona kadastrale Pustenik, parcela kadastrale Nr.186-0 me kulturë mal i klasit pestë në vendin e quajtur Bibinoll P.SH EKONOMIA E PYJEVE zona kadastrale Pustenik, parcela kadastrale Nr.229-0 me kulturë mal i klasit pestë në vendin e quajtur Bibinoll P.SH EKONOMIA E PYJEVE , parcela kadastrale Nr.511-0 mal i klasit pestë dhe gjashtë në vendin e quajtur Bibinoll P.SH EKONOMIA E PYJEVE .

II

Komuna e Hanit të Elezit në parcelat e lartë shënuara nuk ka ndonjë plan rregullativ hapësinor, kurse pala për dokumentacionet e tjera të nevojshme duhet të drejtohet në organet përkatëse.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Pala, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 26.01.2017



Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr 623 /2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, 12.2 shkronja (d), Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 numër Nr. 05/L-125 neni 18 pika 2, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2017 merr:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E VENDIMIT PËR RIALOKIMIN E MJETEVE FINANCIARE

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për rialokimin e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale në kuadër të projektit Mjete të lira për bashkë investime.

II

Nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale, në kuadër të programit Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nën programi (66480) nga projekti me kod 41641 Mjete të lira për bashkëinvestime të bëhet rialokimi i mjeteve nga nën-kategoria 33200 Transfere kapitale për entitete jopublike shuma prej 30,000 € të rialokohet në nën-kategorinë 31701 Kamion.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Financave – Departamenti i Buxhetit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 26. 01. 2017



Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava